

VENDIM
Nr. 682, datë 16.8.2013

PËR RISHPËRNDARJE FONDESH NDËRMJET PROGRAMEVE, BRENDA BUXHETIT TË VITIT 2013, MIRATUAR PËR MINISTRINË E MJEDISIT, PYJEVE DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 44 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe të ligjit nr. 119/2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Rishpërndarjen e fondeve, për shpenzime kapitale, ndërmjet programeve të miratuara për Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, në buxhetin e vitit 2013, si më poshtë vijon:

a) Në programin “Administrimi i pyjeve”, për “Pagesa të prapambetura të projektit të zhvillimit të burimeve natyrore”, për kosto lokale, të shtohet fondi prej 1 840 000 (një milion e tetëqind e dyzet mijë) lekësh

b) Në programin “Mbrojtja e mjedisit”, për “Kosto lokale të projektit të ozonit”, të zbritet fondi prej 1 840 000 (një milion e tetëqind e dyzet mijë) lekësh

c) Në programin “Administrimi i pyjeve”, për “Pagesa të prapambetura të projektit të zhvillimit të burimeve natyrore”, për TVSH, të shtohet fondi prej 1 000 000 (një milion) lekësh.

ç) Në programin “Mbrojtja e mjedisit”, për “Forcimi i kapaciteteve të Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave për hartimin dhe zbatimin e legjislacionit (cilësia e ajrit)”, të zbritet fondi prej 1 000 000 (një milion) lekësh.

2. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha